

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “GJOKA 87” sh.p.k**

Sot, më datë 17.12.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), në selinë e Shoqërisë “GJOKA 87” sh.p.k, - regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 18.04.2018 me Numër Unik Identifikimi (NIPT) L81618040T me adrese Rr. “Dora D’Istria, Hyrja nr. 6, Tirane Pasuria me numër 7/637+1-N5, Z.K 8270, Tiranë e cila ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901, dt.14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe Statutin e shoqërisë, e thirrur në mbledhje me kërkesë të shoqërisë “Gjoka Konstruksion” sh.a perfaqesuar nga administratori dhe aksioneri i vetem i saj, z.Rrok Gjoka në cilësinë e zotëruesit të 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, sipas njoftimit të bërë datë 14.12.2018, u paraqit ortaku i shoqërisë:

**Rendi i ditës:**

1. Rritja e kapitalit të shoqërisë “Gjoka 87” sh.p.k. me ane të kontributit të ortakut të Vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a. kundrejt detyrimeve që shoqëria “Gjoka 87” shpk ka ndaj ortakut të saj të vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a.
2. Caktimin e Ekspertit Kontabel për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit.

Ne zbatim të Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në vijim, Asambleja e Ortakëve në unanimitet, perfaqesuar nga Ortaku i vetem i saj,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rritjes së kapitalit të shoqërisë “Gjoka 87” shpk me ane të kontributit të ortakut të Vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a. kundrejt detyrimeve që shoqëria “Gjoka 87” shpk ka ndaj ortakut të saj të vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a. në shumën 1.729.272.309 leke, prej furnizimeve të shërbimit të punimeve në ndërtim, sipas Fatures Tatimore nr’ fature 8, nr serial 66232508, date 30/11/2018.
2. Caktimin i Ekspertes Kontabel znj Shpresa Breçani me nr license 143, për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që vete ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij pranë QKR-se.

Meqenëse nuk ka asnjë çështje tjetër për të diskutuar mbledhja u deklarua e mbyllur.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**“GJOKA KONSTRUKSION” sh.a**

Perfaqesuar nga :

Rrok GJOKA





**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “GJOKA 87” sh.p.k**

Sot, më datë 28.12.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), në selinë e Shoqërisë “GJOKA 87” sh.p.k, - regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 18.04.2018 me Numër Unik Identifikimi (NIPT) L81618040T me adrese Rr. “Dora D’Istria, Hyrja nr. 6, Tirane Pasuria me numër 7/637+1-N5, Z.K 8270, Tiranë e cila ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901, dt.14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe Statutin e shoqërisë, e thirrur në mbledhje me kërkesë të shoqërisë “Gjoka Konstruksion” sh.a perfaqesuar nga administratori dhe aksioneri i vetem i saj, z.Rrok Gjoka në cilësinë e zotëruesit të 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, sipas njoftimit të bërë datë 14.12.2018, u paraqit ortaku i shoqërisë:

**Rendi i ditës:**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i raportit per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te hartuar nga ekspertja kontabel.

Ne zbatim te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtarete dhe shoqerite tregtare” ne vijim, Asambleja e ortakëve ne unanimitet, perfaqesuar nga ortaku i saj,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e e raportit per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise “Gjoka 87” sh.p.k me ane te kontributit te aksionerit te Vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a. kundrejt detyrimeve qe shoqeria “Gjoka 87” shpk ka ndaj ortakut te saj te vetem “Gjoka Konstruksion” sh.a. ne shumen 1.729.272.309 leke, prej furnizimeve te sherbimit te punime ne ndertim, sipas Fatures Tatimore nr fature 8, nr serial 66232508, date 30/11/2018.
2. Kapitali i shoqerise pas zmadhimit nga 80.000.000 leke behet 1.809.272.309 leke, i perbere teresisht nga kontribute ne para.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që vete ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij të veproji në emër dhe për llogari të shoqërisë për depozitim e këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij pranë QKR-se.

Meqenëse nuk ka asnjë çështje tjetër për të diskutuar mbledhja u deklarua e mbyllur.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**“GJOKA KONSTRUKSION” sh.a**

**Perfaqesuar nga :**

**Rrok GJOKA**



Shpresa Breçani  
Audituese e Pavarur  
Licence nr. 143

**R A P O R T I**  
**I**  
**AUDITUESES SE PAVARUR**

*Per vleresimin e zmadhimin e kapitalit te shoqërisë*

**“GJOKA 87” shpk**

**NIPT L81618040T**



## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

### **Drejtuar: Ortakut të vetëm të Shoqërisë "GJOKA 87" shpk**

Unë, Shpresa Breçani, me profesion Audituese e Pavarur me license profesionale Nr.143, date 29.06.2005 lëshuar nga IEKA, jam caktuar si eksperte në misionin për rritjen e kapitalit të shoqërisë "GJOKA 87" shpk, sipas Vendimit te Ortakut të vetëm të Shoqërisë "GJOKA 87" shpk dhe ne zbatim te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".


Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe financiar të shoqërisë "GJOKA 87" shpk, jap perfundimet e mia në raportin që vijon:

### **Qellimi i Anagazhimit**

Ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", te Vendimit te Ortakut te vetem te "GJOKA 87" shpk, date 17/12/2018, une, Shpresa Breçani me profesion Audituese e Pavarur kam realizuar angazhimin tim per kryerjen e procedures se vleresimit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise ne para, nepermjet përfshirjes në të të kontributit të ortakut te Vetem "Gjoka Konstruksion" sh.a. kundrejt detyrimeve qe shoqeria "Gjoka 87" shpk ka ndaj ortakut te saj te vetem "Gjoka Konstruksion" sh.a., per furnizimet e sherbimeve të punime në ndërtim, sipas fatures tatimore date 30/11/2018, nr fature 8, nr serial 66232508, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Dhenise se Sigurise. Ky Standad kerkon qe ne te planifikoj dhe te kryej procedurat ne menyre qe te arrij nje nivel te arsyeshme sigurie.

### **Pergjegjesia e Drejtimi**

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen ne perputhje me kerkesat ligjore per pergatitjen dhe paraqitjen e drejtë te deklarimeve financiare, juridike dhe e informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të hartimit te pasqyrave financiare dhe te ndryshimit te kapitalit.



## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

Drejtimi eshte gjithashtu pergjegjës të ndërmarë në kohë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e procesit të zmadhimit të kapitalit, te dorezimit te dokumentacionit prane QKR-se dhe te njoftoje palet e interesuara per procesin e zmadhimit te kapitalit me rezervat në para.

Drejtimi ka pergjegjesine te garantoje se nuk eshte i perfshire ne ndonje proces falimentimi apo likuidimi.

### **Pergjegjesia e Audituesit te Pavarur**


Pergjegjesia ime eshte te jap nje opinion mbi sigurine e procesit bazuar në verifikimin e procedurave, te metodave te perdoruara per te arritur zmadhimin e kapitalit ne para, si dhe pershtatshmerine e perdorimit te ketyre metodave.

### **OPINION**

Sipas Opinionit tim, pasi verifikova procedurat për zmadhimin e Kapitalit të shoqerise "GJOKA 87" shpk, opinionimi im per Vendimin e Ortakut te vetem eshte i drejte dhe sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

Audituese e Pavarur  
Shpresa BREÇANI nr.Lic.143.

Tirane, me 28/12/2018





## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

### I. BAZA LIGJORE PER KRYERJEN E KETIJ MISIONI ESHTË:

1. Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Ligji Nr.9723 date.03.05.2007 "Per QKR-ne".
3. Vendimi i Ortakut te vetem te Shoqerise "GJOKA 87" shpk.
4. Statuti dhe Akti i themelimit te shoqerise "GJOKA 87" shpk.
5. Pasqyrat financiare 11- mujore, deri me date 30/11/2018.
6. Kontrata koncensionare "Permiresimi, ndertimi, operimi, dhe mirembajtje e Rruges se Arbrit", sipas kontrates se lidhur me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise Nr.553 rep, Nr.247 kol, date 16.03.2018,
7. Fatura tatimore nr 8, date 30/11/2018 e leshuar nga shoqeria "Gjoka Konstruksion" sha per sherbimet e ndertimit per shoqerine "Gjoka 87" shpk.
8. Akt Marreveshja mes paleve, shoqerise "Gjoka Konstruksion" sha dhe shoqerise "Gjoka 87" shpk per kompesim te detyrimeve me kontribut ne kapital.

### II. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË.

Shoqëria "GJOKA 87" shpk, është krijuar si person juridik regjistruar prane QKB me date 31/07/2018, me kapital fillestar te nenshkruar ne vleren 80.000.000 leke dhe ortak te vetëm shoqerine "Gjoka Konstruksion" sha. Kapitali eshte i perbere nga 1 kuote me vlere 80.000.000 leke.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:** Zbatimin e kontrates koncensionare/ppp "Permiresimi, ndertimi, operimi, dhe mirembajtje e Rruges se Arbrit", sipas kontrates se lidhur me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise Nr.553 rep, Nr.247 kol, date 16.03.2018, ne Tirane Shqiperi dhe te miratuar me VKM Nr.180, date 28.03.2018 dhe e botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.50, date 11.04.2018, e cila do t'i kalohet shoqerise Gjoka 87 sh.p.k ne daten e themelimit te saj. Ne kete kuader, shoqeria Gjoka 87 sh.p.k ka te drejte te kryeje te gjitha dhe cdo aktivitet te nevojshem per realizimin e objektit te saj.

**Selia e shoqerise eshte ne adresen:** Rruga Dora D'Istria, Hyrja Nr.6, Nr.Pasurie 7/637+1-N5, Tirane.

Administrator i shoqerise eshte Z. Erind Gjoka.

Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

Pasqyra individuale te pozicionit financiar

<u>AKTIVE</u>	30/11/2018	VITI 2017
<b>Aktive afat gjate</b>		
<i>Aktive afat gjate materiale</i>		
<i>Te tjera aktive afta gjate</i>	36,000,000	
<b>Totali I Aktiveve Afatgjate</b>	<b>36,000,000</b>	
<b>Aktive qarkulluese</b>		
<i>Inventari</i>		
<i>Kliente (neto)</i>	6,942,007,054	
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme(TVSH)</i>		
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme(Tatim Fitimi)</i>		
<i>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</i>		
<i>Likujditete</i>	610,541	
<b>Totali I Aktiveve Qarkulluese</b>		
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>6,978,617,595</b>	
<b><u>KAPITALET E VETA</u></b>		
<i>Kapitali</i>	80,000,000	
<i>Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise meme(perdoret vetem ne PF te konsoliduara)</i>		
<i>Rezerva te tjera</i>		
<i>Rezerva ligjore</i>		
<i>Rezerva rivleresimi</i>		
<i>Fitim (humbje) të pa shperndara</i>		
<i>Fitim (humbje) e vitit ushtrimor</i>	(27,140,557)	
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>	<b>52,859,443</b>	



## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

### **III. SITUATA EKONOMIKO - FINANCIARE E SHOQERISE para momentit te rritjes se kapitalit aksionar dhe krijimit te rezerves ligjore.**

Shoqëria "GJOKA 87" shpk, duke qene se eshte regjistruar per here te pare me date 31/07/2018 eshte ne vitin e saj te pare te aktivitetit dhe ende nuk ka mbyllur pasqyrat financiare te saj te parat. Prandaj ne momentin e vleresimit te zmadhimit te kapitalit nga shoqeria jane hartuar pasqyrat financiare deri me date 30/11/2018, bashkelidhur ketij raporti.

Me Vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise, e cila eshte shoqeria "GJOKA KONSTRUKSION" sha perfaqesuar nga aksioneri, i vetem Rrok Gjoka eshte vendosur si me poshte:

Miratimin e rritjes se kapitalit te shoqerise "Gjoka 87" shpk me ane te kontributit te ortakut te Vetem "Gjoka Konstruksion" sh.a. kundrejt detyrimeve qe shoqeria "Gjoka 87" shpk ka ndaj ortakut te saj te vetem "Gjoka Konstruksion" sh.a. ne shumen 1.729.272.309 leke, prej furnizimeve te sherbimit te punime ne ndertim, sipas fatures tatimore date 30/11/2018, nr fature 8, nr serial 66232508.

Po me te njejtin vendim jam caktuar si Eksperte per hartimin e raportit per vleresimit e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.


### **KAPITALI AKSIONAR PARA RRRITJES .**

Gjendja e **Kapitaleve me date 30/11/2018**, perpara mbylljes se pasqyrave financiare paraqitet si me poshte;

Kapitali ne shumen 80.000.000 leke  
Humbja e periudhes ne shumen 27.140.557 leke  
Total kapitali ne shumen 52.859.443 leke

Nga verifikimet e kryera nga ana ime ne dokumentacionin kontabël, rezulton se kapitali i shoqërisë eshte pasqyruar ne bilanc sipas dispozitave ligjore te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Pasqyrat Financiare te 11 mujorit paraqiten si me poshte:






Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkuar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

**DETYRIME**

<i>Detyrime afat gjate</i>	1,800,052,800
<i>Hua afat gjate</i>	
<i>Grante dhe te ardhura te shtyra</i>	
<hr/>	
<b><i>Totali I Detyrimeve Afatgjata</i></b>	<b>1,800,052,800</b>
<b><i>Detyrime afat shkurter</i></b>	
<i>Llogari te pagueshme (furniture)</i>	5,125,532,554
<i>Kesti afat shkurter i huase afat gjate</i>	
<i>Hua afat shkurter</i>	
<i>Te drejta dhe detyrime (dividenti)</i>	
<i>Te tjera detyrime afat shkurter ndaj punonjesve dhe tatimoreve</i>	172,798
<i>Provizionet afatshkurtra</i>	
<i>Parapagimet e Arketuara</i>	
<hr/>	
<b><i>Totali I Detyrimeve Afatshkurtra</i></b>	<b>5,125,705,352</b>
<hr/>	
<b><i>Totali I Detyrimeve</i></b>	<b>6,925,758,152</b>
<hr/>	
<b><i>Totali I Kapitalit dhe I detyrimeve</i></b>	<b>6,978,617,595</b>
<hr/>	



Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

Pasqyra e te ardhurave individuale	30/11/2018	31/12/2017
Shitje neto	5,785,005,878	
Te ardhura tjera		
Shpenzime operacionale	(5,799,324,798)	
Paga sigurime shoqerore dhe shendetesore	(1,234,693)	
Amortizimi		
Te tjera shpenzime		
<b>Rezultati nga aktiviteti kryesor</b>	<b>(15,553,613)</b>	
Shpenzime per interesa huaje	(11,586,944)	
Humbje nga diferenca konvertimi		
Te ardhura (shpenzime) financiare		
<b>Shpenzime financiare- neto</b>		
Fitimi përpara tatimit		
Shpenzime te pa zbritshme		
Tatim fitimi		
<b>Fitimi (humbje) neto për periudhën</b>	<b>(27,140,557)</b>	
Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë		
Rivlerësime të pasurive të paluajtshme		
Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse		
<b>Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)</b>		
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën</b>	<b>30/11/2018</b>	<b>31/12/2017</b>
<b>Fitim i atribuar për:</b>		
Aksionerët e Shoqerisë	-27,140,557	0
Te tjera aksione në minorance		
<b>Fitimi i periudhës</b>	<b>-27,140,557</b>	<b>0</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuar për:</b>		
Aksionerët e Shoqerisë	-27,140,557	0
Te tjera aksione në minorance		0
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën</b>	<b>0</b>	<b>0</b>



## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkruar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

Sipas Karteles se Detyrimeve ndaj furnitoreve qe rezulton ne pasqyrat financiare 11-mujore, deri me date 30/11/2018 eshte ne shumen 5.125.532.554 leke.

Kjo shume detyrimi perfaqeson vleren totale te furnizimeve te sherbimit te ndertimit nga shoqeria "Gjoka Konstruksion" sha ndaj shoqerise "Gjoka 87" shpk .

Sipas Akt Marreveshjes midis dy shoqerive Shoqeria "Gjoka Konstruksion" sha ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Gjoka 87" shpk, per faturen e furnizimit te leshuar me date 30/11/2018, me nr.8, dhe nr serial 66232508, me vlere totale 1.729.372.309 leke (perfshire TVSH-ne) nuk pretendon likujdimin e saj, por kjo vlere detyrimi do te kaloje ne zmadhim te kapitalit te shoqerise "Gjoka 87" shpk si kontribut i ortakut te vetem ne para.

### KAPITALI AKSIONAR PAS RRITJES

Zmadhimi i kapitalit është parashikuar te realizohet nëpërmjet shtimit të vleres se kuotave. Burimi i zmadhimit te kapitalit eshte kontributi i ortakut dhe pjeset e reja te zoterimit i takojne Ortakut te vetem te saj.

Gjendja e **Kapitalit** pas zmadhimit, paraqitet ne shumën **1.809.272.309 leke**, i ndare 1 kuote me vlere 1.809.272.309, të zotëruara 100% nga ortaku i vetem shoqeria "GJOKA KONSTRUKSION" sha.

Veprimet kontabel te shoqerise "Gjoka 87" shpk qe pasqyrojne zmadhimin e kapitalit jane:

Debitohet llogaria "**Te pagueshme ndaj Furnitoreve**" per vleren 1.729.372.309 leke, e cila perfaqeson faturen e dates 30.11.2018, nr.8, nr serial 66232508, e pa likujduara deri sot, me date 28.12.2018 ndaj ortakut te vetem te shoqerise "Gjoka Konstruksion" sha me pjesmarrje 100% te kuotave ne kete shoqeri,

Kreditohet llogaria 101 "**Kapitali**" per vleren 1.729.372.309 leke kontribut nga ortaku i vetem.

Ne këto kushte ne pasqyren e DETYRIMEVE dhe te KAPITALIT per Pasqyrat financiare për vitin 2018 do te pasqyrohen ndryshimet përkatëse te pasqyruara me sipër brenda grupit te **Kapitalit**.



## Raport Zmadhimi i Kapitalit te Nenshkuar per Shoqerine "GJOKA 87" shpk

DETYRIMET	Pas zmadhimit	Para zmadhimit	Diferenca
<i>Te pagueshme -Furnitore</i>	3.396.160.245	5.125.532.554	-1.729.372.309
	<b>3.396.160.245</b>	<b>5.125.532.554</b>	<b>-1.729.372.309</b>

KAPITALI	Pas zmadhimit	Para zmadhimit	Diferenca
<i>Kapitali</i>	1.809.272.309	80.000.000	+1.729.372.309
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>	<b>1.809.272.309</b>	<b>80.000.000</b>	<b>+1.729.372.309</b>

### IV. KONKLUZIONE PERFUNDIMTARE

Ne përmbushje te misionit tim si Eksperte Kontabël e Regjistruar, caktuar nga ortaku i i vetem i shoqërisë "**GJOKA 87**" shpk, për përgatitjen e Raportit për Vleresimin e Rritjes se Kapitalit të shoqërisë jap opinion tim si vijon :

1. Vendimi i Ortakut te vetëm te shoqërisë është i drejte dhe i bazuar ne ligj.
2. Kapitalit i shoqërisë "**GJOKA 87**" shpk, nga 80.000.000 leke, pas zmadhimit shkon ne **1.809.272.309 leke**, te zotëruara 100% nga ortaku i vetem "Gjoka Konstruksion" sha.
3. Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet përfshirjes ne te detyrimeve per faturen e sherbimeve te ndertimit nr 8, date 30/11/2018, te palikujduar ndaj ortakut te vetem, ne forme te kontributit ne para dhe ka ekuivalentin e saj ne pasurinë neto te shoqërisë.

*Perfundimisht, mbi bazën e analizave te mësipërme, opinioni im per vendimin e Ortakut te vetem per zmadhimin e Kapitalit, te shoqerise "**GJOKA 87**" shpk është sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".*

Raporti i paraqitur prej meje mund te miratohet nga ana e shoqerise dhe te kalohe per kryerjen e veprimeve te metejshme ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Audituese e Pavarur  
Shpresa BREÇANI nr.Lic.143

Tirane, me 28/12/2018